



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-27/2008,” e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, miratoi këtë:

Draft- V E N D I M

Për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022 shuma prej 917,179.21€ të barten për shfrytëzim në vitin fiskal 2023 .

Neni 1

1.1 Komuna e Suharekës gjatë vitit 2022 ka tejkualuar planin buxhetor të të hyrave vetanake për pjesën e inkasimit të denimeve nga gjykatat, trafikut dhe pyjeve në shumë prej **182,779.44€**.

1.2 Në vitin 2022, të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuara, **2,054,989€**, ndërsa gjatë tërë vitit fiskal 2022, janë grumbulluar gjithsej shuma prej **2,237,768.44€**.

1.3 Mjetet e grumbulluara si tepriçë prej **182,779.44€** dhe shuma e pa shpenzuar që duhet bartur në vitin fiskal 2023 prej **734,399.77€** e si total i bartjes është shuma prej **(182,779.44€+(plus) 734,768.44€)=917,179.21€**, shuma në fjalë duhet të bartet në programin SIMFK-së, dhe të lejohet për alokim, në këto programe dhe kategori ekonomike.

Tabela 1.

Programet/nënprogramet	Mallra dhe Sherbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe Transfere	Invstime Kapitale	TOTAL:
Zyra e Kryetarit (16012)			5,000.00		5,000.00
Administrata (16312)	20,151.00		-		20,151.00
Zyra e Kuvendit (16912)	10,127.03				10,127.03
Inspekcioni(16623)	-				-
Buxheti dhe Financa(17512)	10,657.91		40,000.00		50,657.91
Sherbimet Publike dhe Emergjente (18012)	-	15,542.00		635,638.51	646,180.51
Bujqësia e Zhv.Rural(47012)	10,526.40		50,000.00		60,526.40
Planifikim e Urbaniz. (66365)	8,109.36				8,109.36
Administra e Shëndetësis(73021)	-				-
Shëndeti primar-QKMF (73750)	-			5,000.00	5,000.00
Kultur Rini e Sport (85012)	-		100,000.00		100,000.00
Administrata- Arsimit (92060)	2,810.03	8,616.97			11,427.00
Arsimi I mesem(94530)	-				-
TOTAL:	62,381.73	24,158.97	195,000.00	635,638.51	917,179.21

Tabela 2.

Nr.	EMRI I PROJEKTIT	Bartja 2022
	Sherbimet Publike dhe emergjente-Infrastrukturë rrugore :	630,638.51
1	50659 Ndertimi dhe rregullimi i varrezave në qytet - Suharekë	40,000.00
2	52002 Ndertimi i rrugëve lokale: "Sherif Aga", "Pavaresia" segment, "Esat Rexhepi", "Lugjet e Verdha" ne Gjinoc	10,000.00
3	52014 Ndertimi i rrugëve: "Regjep Velia"- me segment, "Molika", "Shaljanet"- segment, "Kovaqi ", "Tafa", "Jetush Shala", "Haxhi Shania", etj ne Mushtisht.	13,178.29
4	52023 Ndertimi dhe rregullimi i Kolektorit ne rrugen "Skenderbeu"- Suharekë	264,500.00
5	50568 Ndertimi i rrugëve "Sadik Shasha", "Sadik Sejda", "Haki Sokoli.", "Haki Sokoli", "Ali Bytyqi", "Minatori", "Jemin Jemini", "Bajram Kurti" në Mushtisht.	7,786.83
6	52075 Ndertimi i rrugëve "Haxhi Qerimi", "Hajdaraj" ne Bagevc	3,173.39
7	52373 Ndertimi i rrugës Peqan i Vogël-Semetisht .	52,000.00
8	52364 Ndertimi i rrugëve lokale "BUNARI I LIMANIT" DHE "FEHMI MORINA"- Vazhdim në SAMADRAXHE	40,000.00
9	52533 Ndertimi dhe sanimi i rrugëve lokale "SOPIJE-VRANIQ" DHE "REQAN-BUKOSH"	200,000.00
	Shërbimi i Kujdesit Primar (QKMF) :	5,000.00
1	50507 Blerja e paisjeve dhe montimi i sistemit të menaxhimit të radhës QKMF	5,000.00
	TOTALI :	635,638.51

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendim i njeiti do të shërbej për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake të mbetura pa u shfrytëzuar nga viti 2021 dhe viti 2022, e të cilat do të barten dhe shpenzohen në vitin fiskal 2023.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr- _____
Më datë _____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI